



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

U-POLIS  
NR. 68/16 PROT.  
Dt. 24.05.2016

MINISTRI

Nr. 5242 Prot.

Tiranë, më 20.05 2016

URDHËR

Nr. 270, datë 20/05/2016

**"PËR  
AKREDITIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË,  
BACHELOR NË "INXHINIERI NDËRTIMI", TË FAKULTETIT "ARKITEKTURË  
DHE DIZAJN", TË UNIVERISTETIT "POLIS"**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 138 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimit Nr.424, datë 28.4.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Inxhinieri ndërtimi", në Fakultetin Arkitekturë dhe Dizajn, të Universitetit "Polis", që realizohet me 180 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike/6 semestra, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në "Inxhinieri Ndërtimi".
2. Ky program studimi akreditohe në bazë të Vendimit nr. 122, datë 18.02.2016, të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Ngarkohet Inspektorati Shtetëror për Arsimin dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Universiteti "Polis".

*Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare"*

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

